



| | | | |
|---|-----------------------|-------------------------------|---------------------------------|
| Pranimë / Dorezuar Prenjës / Prilaz Received / Delivery | 12.07.2023 | 3 | vite years |
| Organ / Njësia Org / Unit | Nr Prot Pr Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicitimi Quantity |
| SKM/SHK | 5764/2023 | | 1/5 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.826/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.826/2023 të datës 08.06.2023, të parashtruar nga ankuesi [] i nga Fushë Kosova, kundër Vendimit me numër protokollit 605 të datës 02.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Fushë Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 12.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.826/2023 e datës 08.06.2023, e parashtruar nga ankuesi [] ndërsa **Anulohet** Vendimi me numër protokollit 605 i datës 02.06.2023 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Fushë Kosovës.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës që ankuesit t’i bëjë kompensimin e 20 % të pagës së ndaluar sipas Vendimit me numër protokollit 280 të datës 14.03.2023 të Komisionit Disiplinor, ndërsa **obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Fushë Kosovës që të largoj nga dosja personale e nëpunësit civile si dhe regjistri përkatës masën disiplinore të shqiptuar sipas Vendimit me numër protokollit 280 të datës 14.03.2023 të Komisionit Disiplinor, të gjitha këto brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [] (me tej vetëm ankuesi), nëpunës civil në Komunën e Fushë Kosovës, më datë 08.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 605 të datës 02.06.2023 të Komisionit Disiplinor të

Komunës së Fushë Kosovës, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa, kjo e fundit me datë 23.06.2023, ka përcjell shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4632/2023 të datës 08.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 605 të datës 02.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Fushë Kosovës; Vendimin A.nr.574/2023 të KPMSHCK-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 14.06.2023 dhe 20.06.2023; Ankesën me numër protokolli 3049/2023 të datës 28.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 280 të datës 14.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Fushë Kosovës; Kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore e datës 14.02.2023; Njoftim për seancë të Komisionit Disiplinor të datës 16.02.2023; Përgjigjen për seancën e procedurës disiplinore nga ankuesi me datë 21.02.2023 për Kryetarin e Komisionit Disiplinor; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin e datës 24.01.2023; Listën e pushimit vjetor për ankuesin nga SIMBNJ; Kërkesën për takim fillestar e datës 01.06.2022; Procesverbali i takimit hyrës i datës 03.06.2022; Emailin e datës 07.06.2022 nga A.S për ankuesin; Emailin e datës 06.06.2022 nga ankuesi për A.S; Kërkesën për takim fillestar e datës 30.01.2022; Procesverbalin e takimit hyrës i datës 15.02.2023; Plani Vjetor i datës 22.12.2022 për Njësinë e Auditimit të Brendshëm; Plani Strategjik për Njësinë e Auditimit të Brendshëm për periudhë 2023-2025 i datës 22.12.2022; Raporti vjetor i punës dhe aktiviteteve të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022; Emailin e datës 20.02.2023, 16.02.2023 nga ankuesi; Emailin e datës 13.02.2023 nga ankuesi për V.G; Emailin e datës 13.02.2023 nga ankuesi për B.B; Emailin e datës 03.02.2023 nga ankuesi për ...; Emailin e datës 31.01.2023 nga ankuesi për M.K; Emailin e datës 15.02.2023 nga ankuesi për...; Emailin e datës 13.02.2023 nga D.M për B.B; Raporti i Auditimit për Komunën e Fushë Kosovës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.04.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 3779/2023; Akt Emërimit me numër protokolli 730 i datës 07.07.2016; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 24.02.2023; Kërkesën për prova shtesë të datës 28.04.2022 nga KMPSHCK për Komunën e Fushë Kosovës, Përgjigjen në kërkesë për prova shtesë e datës 04.05.2023 nga Komuna e Fushë Kosovës; Raportin e vijueshmërisë për ankuesin për periudhën nga data 01.01.2022 deri 31.12.2022; Formularin e rezultateve në punë i datës 24.01.2023, për ankuesin.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Fushë Kosovës dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit me numër protokolli 730 të datës 07.07.2016, ushtron pozitën e punës *Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm*.

Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, më datë 14.02.2023 ka parashtruar pranë Komisionit Disiplinor kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, për shkak të pretendimeve për kryerje të shkeljeve të rënda sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3 dhe 3.9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Komisioni Disiplinor më Vendimin më numër protokollit 280 të datës 14.03.2023, ka shpallur përgjegjëse ankuesin për shkelje të rënda të detyrave të punës sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3 dhe 3.9 si dhe nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë duke i shqiptuar masat disiplinore *"ndalim për 20% në pagë për periudhën pesë mujore dhe pezullimin e përkohshëm të auditimit për periudhën dhjetë mujore"*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vendosur sipas ankesës së ankuesit të datës 28.03.2023, me Vendim A.nr.574/2023 të datës 10.05.2023, ka anuluar Vendimin më numër protokollit 280 të datës 14.03.2023, ndërsa çështjen e kthen në rishqyrtim dhe vendosje të Komisionit Disiplinor i Komunës së Fushë Kosovës. Ky i fundit në zbatim të vendimit të Këshillit, nxjerr Vendimin me numër protokollit 605 të datës 02.06.2023 për rishqyrtimin e Vendimit nr.280 të datës 14.03.2023 duke shfuqizuar të njëjtin lidhur me pjesën e pezullimit të përkohshme të auditimit për periudhën dhjetë mujore.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 605 të datës 02.06.2023 të Komisionit Disiplinor i Komunës së Fushë Kosovës, pretendon se nuk janë respektuar udhëzimet nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sepse rasti nuk është rishqyrtuar por vetëm është bërë korrigjimi i vendimit paraprak. Shton se Komisioni Disiplinor me vendimin e kundërshtuar nuk ka saktësuar se vilat janë veprimet dhe mosveprimet që e bëjnë përgjegjës ankuesin për shkelje të rëndë disiplinore. Propozon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe anuloj vendimin e kundërshtuar më ankesë.

Në funksion të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë referuar procedurës disiplinore të nëpunësve civilë përkatësisht nenin 45 më të cilin përcaktohet se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore dergjët veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se nëpunësi civil mbanë përgjegjësi disiplinore në rastet kur vërtetohet se i njëjti me veprimet ose mosveprimet e tij ka shkelur dispozitat e ligjit në fuqi ndërlidhur me detyrat funksionale dhe përgjegjësit e punës për pozitën që mbanë, dhe mbi bazën që të jenë plotësuar në mënyrë komulative elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht, organi kompetent në realizimin e autoritetit publik me rastin e vendosjes lidhur me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të nëpunësve civil janë të obliguar që të veprojnë në pajtueshmëri me parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit, barazisë, mosdiskriminimit, objektivitetit, paanësisë, pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, si dhe parimin e informimit dhe ndihmës aktive siç është përcaktuar me nenin 4, 5, 6, 7, 9, 10, dhe 11 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu, Kolegji mori parasysh edhe dispozitat e nenit 46 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilat janë përcaktuar në mënyrë shprehimore shkeljet disiplinore, ku parashihet se: *Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore.* 2. *Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta.* 3. *Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë...”*

Rrjedhimisht, nisur nga kuadri ligjor si me sipër, Kolegji ka analizuar aktin administrativ të kundërshtuar me ankesë ndërlidhur me provat tjera materiale të lëndës dhe si rrjedhë ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Fushë Kosovës, ka qenë i detyruar që në zbatim të vendimit të Këshillit A.nr.574/2023 të datës 10.05.2023 të shqyrtoj çështjen administrative të iniciuar sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës të datës 14.02.2023 për inicim të procedurës disiplinore nga ankuesit duke marrë për bazë të gjitha rekomandimet dhe pikëpamjet juridike të Këshillit të dhëna në vendim. Rrjedhimisht Komisioni Disiplinor nuk kishte marrë parasysh se Vendimi me numër protokollit 280 i datës 14.03.2023 i nxjerr nga vet ky komision është shfuqizuar me Vendim të Këshillit A.nr.574/2023 dhe si tillë nuk ka mundur të ndryshohet qofte pjesërisht apo në tërësi dhe mbi këtë bazë i njëjti nuk ka bërë ri shqyrtimin e çështjes disiplinore të filluar sipas kërkesës së datës 14.02.2023 përkatësisht nuk ka bërë ri shqyrtimin e fakteve dhe provave në mënyrë që të vërtetohet saktë dhe drejt përgjegjësia disiplinore e ankuesit lidhur me shkeljet e pretenduara sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore.

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave materiale të kësaj çështje juridiko-administrative ka gjetur se kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit ishte bërë mbi bazën e mos raportimit të ankuesit të Kryetari i Komunës, mungesës së komunikimit, vijueshmërisë në punë, nxjerrjen e dokumentacionit jashtë pa autorizim të Kryetarit të Komunës, mos analizimi e çështjeve paraprakisht me menaxhmentin e drejtpërdrejt, tejkalim të kompetencave dhe procesimi i dokumenteve mbështetur në bindjet politike e pa shtjellim të lëndëve, ndërsa nga provat e lëndës të parashtruara nga vet organi i punësimit në këtë rast Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Fushë Kosovës, Kolegji nuk ka gjetur dëshmi të citat argumentojnë faktin se ankuesi me veprime apo mosveprime është përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore lidhur me shkeljet e pretenduar sipas shkresës së datës 14.02.2023 të Kryetarit të Komunës, rrjedhimisht sipas shkresave të lëndës nuk ka dëshmi nga të cilat konstatohet fakti se ankuesi nuk ka raportuar të Kryetari i Komunës apo ka munguar komunikimi mes tyre, nuk posedohet lista apo regjistra elektronik lidhur me vijueshmërinë e punës së ankuesit e mbi bazën e të cilave dokumente mund të vërtetohej prezenca dhe mos prezenca e ankuesit në punë. Për më tepër, Kolegji nga provat e ofruar nga palët në procedurë nuk ka gjetur dëshmi mbi ekzistimin e ndonjë masë disiplinore paraprake të shqiptuar

ndaj ankuesit, si dhe dëshmi për raportim të rastit të organet kompetenteve lidhur me nxjerrjen e dokumentacionit nga ankuesi jashtë institucionin pa autorizim të Kryetarit të Komunës dhe tejkalim të kompetencës, andaj, mbi bazën e kësaj gjendje faktike nuk mund të vërtetohet së ankuesi është përgjegjës për shkelje disiplinore siç pretendohet në kërkesën për inicim të procedurës disiplinore, kështu që edhe pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara.

Nisur nga konstatimet si me sipër, Kolegji në vështrim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nenparagrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton së një akt administrativ i nxjerr me shkelje procedurale dhe në kundërshtim me dispozitat materiale është akt i paligjshëm, andaj në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.826/2023

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Fushë Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

